Republika e Kosovës
**Komuna e Malishevës**

**Drejtoria Për Arsim dhe Edukim**

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI KOMUNËS-MALISHEVË
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVË-SKUPŠTINA OPŠTINE MALIŠEVO
PRANUAR MË-
ACCEPTED ON 28/04/2023
PRIMLJENO:
Nr.No.Br. 11/1072

*Nr: 11//______*

*Më.____________*

Në bazë të nenit 81 të Ligjit për të punës nr. 03/L-212 , nenit 35 të Ligjit për arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës me nr. 04/L-032, nenit 5 të Ligjit për arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 05/2021 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm,Udhëzimin Administrativ nr.08/2021, Udhëzimin Administrativ nr.05/2015 Për normativin për mësimdhënsit e arsimit profesional Udhëzimit Administrativ( MPMS)Nr.07/2017 për rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik, Drejtoria për Arsim dhe Edukim shpallë:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TÊ PUNËS

| Nr. | Niveli, Shkolla | Pozita | Vendi i lirë/zëvendësim | Numri i pozitave | Orë mësimi |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | SHMP IAAP në Kijevë Klasa e dhjetë (10) | Ndertimi dhe funksioni i trupit të njeriut, Edukim shendetsor dhe parandalimi i infeksionit,Kujdesi shëndetësor, Modul zgjedhor | I lirë | 1 | 3+1+2+1=8 orë mësimore |
| 2 | SHMP IAAP në Kijevë klasa e njëmbëdhjetë (11) | Etika në shëndetsi, formologji dhe dozologji, shëndeti i të posalindurit , të ushqyerit e të posalindurit | I lirë | 1 | 1+1+1+2+1 +1+1=8 orë mësimore |
| 3 | SHMP IAAP në Kijevë klasa e njëmbëdhjetë (11) | Opsterik me kujdes I/II | I lirë | 1 | 1+7=8 orë mësimore |

**I.Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet, si vijon:**

- Formulari i aplikimit (merret në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në KK Malishevë);
- Dokumenti personal kopje (letërnjoftim ose pasaportë);
- Rezymeja personale (CV);
- Diplomat e kualifikimit;
- Certifikata (certifikata në vend të diplomës duhet të jenë jo më të vjetra se gjashtë (6) muaj nga data e diplomimit);
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Kandidatët të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës, duhet t'I kenë diplomat e nostrifikuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.
- Dëshmi të përvojës së punës në institucionet edukative arsimore (nëse ka);
- Ekstrati i lindjes

**II. Kushtet dhe Kualifikimi:**

Për këto vende të lira të punës të shjpalluar në konkurs kërkohet përgatitja edekuate profesionale sipas Udhëzimit Administrativ nr. 05/2021 (Për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të përgjithshëm) Udhëzimit Administrativ-MASHT nr.08/2021(Për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të përgjithshëm) dhe Udhëzimi Administrativ (Për Normativin për mësimdhënsit e arsimit profesional).

## III. Vlerësimi i kandidatëve

- Me këtë konkurs do të zhvillohen procedurat e rekrutimit për vitin shkollor 2023/2024 (Shtator 2023 – Gusht 2024);
- Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kritereve të konkursit publik, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim.
- Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshtrohen intervistimit me gojë.
- Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mblidhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjedhen në pozitat e lartpërmendura;
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave, rezultatet përfundimtare të vlerësimit do të shpallen në web-faqen zyrtare të Komunës të Malishevës;

## IV. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Të gjithë kandidatët e interesuar duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësuara të dorëzohen pranë Qendrës për Shërbim me Qytetar në Komunën e Malishevës objekti i ri i Komunës, nga data, 08.08.2023 deri me datën 22.08.2023.
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Nëse aplikohet për dy pozita a më shumë, kandidatët duhet të dorëzojnë aplikacione të veçanta;
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse

- Data e njoftimit në web faqen; https://kk.rks-gov.net/malisheve/category/shpalljet/,https://kk.rks-gov.net/malisheve/, është prej dt; 08.08.2023 deri me datën 22.08.2023, ndërsa data e aplikimit është nga data, 23.08.2023 deri me datën, 06.09.2023

  **Vërejtje**: Data e njoftimit do të mbetët 15 ditë për arsyje të mos na paraqiten vonesa në fillimin e ri të proqesit edukativo arsimor për vitin shkollor 2023/2024.

Dokumentet e kompletuar dorëzohën të fotokopjuar, ndërsa dokumentet origjinale prezentohen në intervistë. Dokumentët e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni.

Në rast të ndonjë nevoje eventuale për mësimdhënës/e gjatë vitit shkollor 2023/2024 dotë bvëhen angazhime sipas renditjes së listave të publikuar me rastin e shpalljes së rezultateve, e cila konsiderohet si listë pritëse.

**Vërejtje:** Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen

Në mungesë të kandidatëve me kualifikim përkatës, do të shqyrtohen edhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim më të përafërt.

**Themelimi i marrëdhënies së punës:**

Mrëdhënia e punës themelohet vetëm nga dita e nënshkrimit të kontratës së punës.

**Drejtoria për Arsim dhe Edukim**

Arbëreshë Krasniqi